



REPUBLIKA E SHQIPËRIË

MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE
SPITALI RAJONAL “MEMORIAL” FIER
NJËSIA E PROKURIMIT



Nr. _____ prot.

Fier, më 19.03.2024

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Blerje materiale mjekimi MM1”, Marrëveshje Kuadër - me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 12 muaj.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

Kodet CPV: - 33140000-3 (materiale mjekimi te konsumeshme)

VLERA E FONDIT LIMIT: 23 332 457 (njëzet e tre million e treqind e tridhjet e dy mijë e katërqind e pesëdhjet e shtatë) Lekë pa TVSH.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Spitalit Rajonal “Memorial” Fier” ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës 3 .;
- b. Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Kriteri Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

2.1.1 Sipas kritereve të përgjithshme të kualifikimit.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

Kriteri 2.2.1 Vërtetim nga Dega e Tatimeve për xhiron vjetore të realizuar gjatë **3 (tre) viteve** te fundit (**2021, 2022, 2023**), ku vlera e xhiros **për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e ulët se 23 000 000** lekë (pra kjo vlerë e xhiros minimale vjetore nuk tejkalon vlerën e parashikuar të kësaj kontrate).

Argumentimi per Kriterin 2.2.1: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.Referuar parashikimeve ligjore të nenit 43, pika 2, germa ”b”, për procedurat me objekt mallra me fond limit ndermjet kufirit te ulet dhe te larte monetar, siç është rasti i kësaj procedure, maksimumi i xhiros vjetore te kerkuar nuk duhet te tejkaloje vlerën e parashikuar të kësaj kontrate.

Kapaciteti teknik:

Kriteri 2.3.1 Dëshmi nga operatori ekonomik për furnizime të mëparshme të ngjashme për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të kryera gjatë tre viteve të fundit , në një vlerë jo më të ulët se **9 200 000 lekë** (pra kjo vlerë totale e kontratave të mëparshme të realizuara gjatë tre viteve të fundit , nuk tejkalon 40% të vlerës së parashikuar të kësaj kontrate).

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik per permbushjen me sukses të kontratës, ku e shënohet vlera, afati i përfundimit te kontrates ose/dhe fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe sasitë e mallrave të furnizuara.
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes, te plotesuara sipas kerkesave te legjislacionit ne fuqi, dhe te deklaruar ne organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasitë e mallrave të furnizuara.

Argumentimi kriteri 2.3.1: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë ne vlerën e cila nuk tejkalon 40% të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.Ky kriter vendoset me qëllim njohjen e origjinës së mallit dhe kompaninë prodhuese për të identifikuar në mënyrë të qartë atë gjatë lëvrimit të tij dhe për të pasur sigurinë

që i njëjti mall i ofertuar do të lëvrohet në destinacion dhe keto kërkesa i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e mundësisë së OE për përmbushjen me sukses të kontratës pra të garancisë së furnizimit të mallit objekt prokurimi.

Kriteri 2.3.2: Ofertuesi të paraqesë Autodeklarate mbi origjinën e mallit (vendi i prodhimit dhe kompania prodhuese) për secilin artikull, për plotësimin e afatit të skadencës së tyre, si dhe respektimit të specifikimeve teknike që oferton. Shënim: Data e skadencës për materialet mjekësore të konsumit objekt prokurimi, në ditën e lëvrimit të mallit duhet të jetë jo më e vogël se 1 vit.

Argumentimi për kriterin 2.3.2: Ky kriter vendoset me qëllim njohjen e origjinës së mallit dhe kompaninë prodhuese për të identifikuar në mënyrë të qartë atë gjatë lëvrimit të tij dhe për të pasur sigurinë që i njëjti mall i ofertuar do të lëvrohet në destinacion në përputhje me nenin 40, pika 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, dhe keto kërkesa i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e mundësisë së OE për përmbushjen me sukses të kontratës pra të garancisë së furnizimit të mallit objekt prokurimi.

Kriteri 2.3.3 : Operatori ekonomik duhet të paraqesë Autorizim të vlefshëm të lëshuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për tregëtim të pajisjeve mjekësore.

Argumentimi kriteri 2.3.3 : Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” si dhe Në Ligjin Nr. 89/2014 “Për Pajisjet Mjekësore” neni 21 i tij.

Kriteri 2.3.4 : Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë çertifikatën ISO 9001 mbi “Sistemet e menaxhimit të cilësisë” dhe nëse operatori ekonomik ofertues është prodhues i artikujve të ofruar duhet të paraqesë çertifikatën SSH EN ISO 13485:2016 “Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë për Pajisjet Mjekësore”, ose EN ISO 13485:2016 mbi “Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë për Pajisjet Mjekësore” për tregëtim të pajisjeve mjekësore në përputhje me objektin e prokurimit, lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose nga organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Certifikata kërkohet të jetë e vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit.

Kriteri 2.3.5 Operatori ekonomik ofertues në rastet kur nuk është prodhues i artikujve objekt prokurimi, duhet të paraqesë autodeklarate që furnizuesi nga i cili siguron artikujt objekt prokurimi është konform standardeve të cilësisë ISO 9001 mbi “Sistemet e menaxhimit të cilësisë” ose EN ISO 13485 mbi “Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë për Pajisjet Mjekësore” ose SSH EN ISO 13485 mbi “Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë për Pajisjet Mjekësore”, të vlefshme, në përputhje me objektin e prokurimit, lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose nga organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Argumentimi për kriterin 3.3.4 dhe 2.3.5 : Në bazë të nenit 79/1, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik” si dhe neneve 40 si dhe 44 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që Autoriteti ose enti kontraktor të vërtetojë se mallrat objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin çertifikatën të lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Kjo dispozitë zbatohet edhe

kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit. Bazuar në këto dispozita Autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë ofertuesve dorëzimin e certifikatave ose dokumenteve të ngjashme, të lëshuara nga organe të pavarura, që vërtetojnë pajtueshmërinë e tyre me standardet e kërkuara të cilësisë, veçanërisht sa i takon:a) garantimit të aksesit të personave me aftësi të kufizuara;b) efikasitetit të energjisë;c) sistemeve të menaxhimit mjedisor.

Kriteri 2.3.6 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë autodeklarate për pajisjet mjekesore nga ofertuesi (distributori/prodhuesi) për konformitetin me normat MDD 93/42/EEC (ose MDR) ose IVD 98/79 EC (të përditësuar), ose EU 2016/425 (të përditësuar) ose FDA ose (EU) 2017/745, kur është e aplikueshme, sipas Direktivave dhe klasifikimit të Keshillit të Europës, bashkelidhur me kopjet e certifikatave perkatëse CE/DC (Deklarate konformiteti) ose FDA, origjinale ose fotokopje të perkthyer dhe të noterizuara të vlefshme në momentin e dorëzimit të ofertave.

Argumentimi për kriterin 2.3.6: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 44, pika 3.4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se Certifikatat perkatëse që i mundëson Autoritetit Kontraktor për të verifikuar dhe krijuar besimin që OE ofertues është në gjendje të realizojë punën/shërbimin në mënyrë cilësore që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente kompetente.

Kriteri 2.3.7 : Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë Autorizim të leshuar nga firma prodhuese ose distributori zyrtar i autorizuar nga prodhuesi /MAH/ për Shqipërinë (ku të provohet/dokumentohet lidhja e tyre me prodhuesin), nëpërmjet të cilit konfirmohet se autorizohet të tregojë materialet mjekesore objekt prokurimi. Autorizimi duhet të jete i vlefshëm në momentin e hapjes dhe dorëzimit të ofertave; dhe origjinale ose fotokopje të perkthyer dhe të noterizuara.

Argumentimi për kriterin 2.3.7 : Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në pikat 2 dhe 4 të nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe pikën 5 të nenit 44 të VKM nr 285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, ku është e cituar: Pika 5. *”Kur është e dukshme që një operator ekonomik e ka të pamundur të marrë etiketën specifike, të cilësuar nga autoriteti/entikontraktor ose një etiketë ekuivalente, brenda afateve kohore perkatëse, për shkak që nuk lidhen me atë operator ekonomik, autoriteti ose enti kontraktor pranon mënyra të tjera vërtetimi të përshtatshme, që mund të përfshijnë një dosje teknike nga prodhuesi, nëse operatori ekonomik në fjalë vërteton se punët, furnizimet ose shërbimet që ai duhet të ofrojë përmbushin kërkesat e etiketës specifike ose kërkesat specifike të cilësuar nga autoriteti/enti kontraktor.* Autorizimi për OE ofertues nga firma prodhuese ose nga distributor i autorizuar prej prodhuesit është një dokument i domosdoshëm për t'u paraqitur, në mënyrë që autoriteti kontraktor të sigurohet që OE ofertues është në gjendje të realizojë punën/shërbimin në mënyrë cilësore që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente dhe që vlerësohet nga ana e njësisë së prokurimit si e nevojshme për realizimin me sukses të kontratës

Kriteri 2.3.8 Për të gjithë artikujt e ofruar të paraqiten Katalogje, ku të përfshihen edhe specifikimet teknike të hollësishme për secilin artikull (pjesët e katalogut që përmbajnë emertimin dhe specifikimet e detajuara teknike të artikullit që ofrohet, nëse nuk janë në gjuhën shqipe, të perkthehen në gjuhën shqipe dhe të noterizohen). Operatori ekonomik duhet

te markoje ne katalogun perkates produktet qe ofron sipas numrit rendor (**te markuara sipas artikullit**) te percaktuar ne formularin e ofertes. Katalogjet do pranohen vetem ne forme elektronike nepermjet sistemit elektronik te prokurimit.

Argumentimi kriterin 2.3.8: Ky kriter është vendosur nga ana e Autoritetit Kontraktor me qëllim vërtetimin se operatori ekonomik i plotëson kërkesat minimale në përputhje me nenin 40, pika 6 b) të VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. ku shprehet rrjedhimisht: 6. Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:b) fotografitë apo katalogët teknikë; dhe/ose;

Kriteri 2.3.9 Operatori ekonomik duhet te paraqese Oferten Teknike, per artikujt e kerkuar ne forme tabele, ku te plotesohet: Specifikimet teknike, Emri i kompanise prodhuese, Origjina e mallit, Skadenca e mallit, Emertimi i katalogut te artikullit/ produktit, Nr. e faqes ku ndodhet produkti, Numri i references se artikullit (kodi) nxjerre nga katalogu i prodhuesit, si dhe certifikimet perkatese per produktet.

Argumentimi për kriterin 2.3.9: Ky kriter vendoset bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 40, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Kriteri 2.3.10 Për gjithë artikujt e kërkuar që paraqiten në Shtojcën 5 dhe 6 të DST, duhet te paraqiten mostra ditën e hapjes se ofertave, me date 11.04.2024 ne oren 09:00. Dorëzimi i kampioneve/ mostrave, të bëhet prane zyrës së protokollit , te mbyllura ne nje zarf /kuti jo transparente te vulosur mbi te cilin te shenohet:

- “Mos e hapni me përjashtim te rasteve kur është i pranishëm Komisioni i Vlerësimit te Ofertave për këtë procedurë prokurimi dhe jo para dates 11.04.2024 ne oren 09:00.
- Se bashku me mostrat ofertuesi duhet te japë edhe një shkresë te vulosur dhe firmosur ku te listohen mostrat qe ndodhen ne zarf/kuti.
- Mbi çdo mostër te dorëzuar, ofertuesi duhet te shënoje Nr.Rendor te Artikullit qe përfaqëson.

Nëse mostrat e dorëzuara, nuk janë te shoqëruara me listën e inventarizimit dhe të identifikuara sipas Nr. Rendor, nëse ka mungesa mostrash për artikuj te veçantë, atëherë oferta do te quhet jo e rregullt dhe rrjedhimisht do te skualifikohet.

Argumentimi për kriterin 2.3.10 : Ky kriter është vendosur nga ana e Autoritetit Kontraktor me qëllim vërtetimin se operatori ekonomik i plotëson kërkesat minimale në përputhje me nenin 40, pika 6 të VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. ku shprehet rrjedhimisht: 6. Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:

- a) mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Në këtë rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të argumentojë kërkesën për mostrat. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të

autoritetit/entit kontraktor. Në rastin e procedurave të zhvilluara me mjete elektronike, autoriteti ose enti kontraktor përcakton qartë procedurën për dorëzimin e mostrave, duke garantuar aksesin e çdo operatori të interesuar si dhe konfidencialitetin për pjesëmarrjen në proces. Mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas nënshkrimit të kontratës, me kusht që kontrata në fjalë të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit; dhe/ose Paraqitja e mostrave i shërben autoritetit kontraktor për të gjykuar më mire mbi përmbushjen e specifikimeve teknike të kërkuara për objektet që prokurohen me qëllim që cilësia e mallit të jetë në përputhje me kërkesat e përcaktuara nga AK.

Shënim: KVO rezervon të drejtën e verifikimit të të dhënave të paraqitura nga ofertuesit.

Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mosdorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Nr	Artikulli	Specifikime teknike	Njësia
	Garza, Bende, te tjera konsumable te pergjithshme		
1	Bende 7cm x 4 m	100% pambuk absorbent, dendesia 24x20	Copë
2	Bende 10 cm x 10 m	100% pambuk absorbent, dendesia 24x20	Copë
3	Bende elastike 7.5cm x 4m	100% pambuk elastik, pesha 80-90g/cm2	Copë
4	Bende allcie 10cm x 2.7m	Paketimi individual plastik	Copë
5	Bende adesive 10 cm x 15 m	Cope e pathurur poroze, elastike. Ana ngjitese e mbrojtur me leter te shqiteshme	Copë
6	Bende 20 cm x 10 m	100% pambuk absorbent, dendesia 24x20	Copë
7	Bende allcie 15cm x 2.7m	Paketimi individual plastik	Copë

8	Bende 8cm x 5 m	100% pambuk absorbent, dendesia 24x20	Copë
9	Bende me parafine 10x10cm	Sterile, jo me shume se 10 cope per pako	Copë
10	Komprese sterile 5cm x 5cm	100% pamb absorbent, dendesia 24x20, 6pala; jo me shume se 5 cope/pako	Copë
11	Komprese sterile 10cm x 10cm	100% pamb absorbent, dendesia 24x20, 12pala; jo me shume se 5 cope/pako	Copë
12	Komprese sterile 10cm x 20cm	100% pamb absorbent, dendesia 24x20, 8pala; jo me shume se 5 cope/pako	Copë
13	Komprese sterile 10cm x 20cm	100% pamb absorbent, dendesia 24x20, 12pala; jo me shume se 5 cope/pako	Copë
14	Komprese sterile 10cm x 10cm	100% pamb absorbent, dendesia 24x20, 16pala; paketim individual (1 cope/pako)	Copë
15	Komprese sterile 10cm x 10cm	100% pamb absorb., dend. 24x20, 6ply; jo me shume se 5 cope /pako	Copë
16	Komprese antimikrobiale 10x10cm	E perbere prej materiali absorbues te imprenjuar me polyhexanide / Ag.	Copë
17	Hemostatik kolageni i absorbueshem	Siperfaqe 100-110 cm ² , me origjine nga tendinet e kuajve, 2.8 mg/cm ² fibrile kolageni ose ekuivalent	Copë
18	Garze abdominale	Garze sterile, e detektueshme nga rrezet-x, 100% pambuk absorbent, me 6 pala, dimensiononi i nje pale 45x45cm, dendesia 28x28, me funde te qepura, me lak lidhes, jo me shume se 5 cope per pako	Copë
19	Garze 91 cm x 100 m	100% pambuk absorbent, dendesia 24x20	m. linear
20	Fiksues kanjule	Fiksues kanjule / afersisht 8.5 cm x 6 cm / materjali , TNT adezive hipoalergjik /poliuretan dhe me garze perthithese ne mes, me kompresim te dyfishte .	Copë
21	Pambuk kirurgjikal	100% pambuk hidrofil, pakete 100g	Copë
22	Pulla injeksioni	Dimensionet e peraferta: 0.9 cm x 3.8 cm , me garze perthithese ne mes dhe dy anet me ngjites antialergjik	Copë
23	Leukoplast 5cm x 5m	cope 100% pambuk, ngjites me permbajtje oksid zingu	Copë
24	Leukoplast antialergjik 5cm x 5m	cope e padeptueshme mendafshi, me ngjites antialergjik	Copë

25	Vaj instrumentash	Vaj per mbrojtjen e endoskopeve dhe instrumentave kirurgjikale qe kane pjese te levizshme. Perdoret pas pastrimit dhe para procesit te sterilizimit. Shishe max. 50-100ml ose ekuivalent	Copë
Sisteme dhe doreza			
27	Sisteme infuzioni	Sistem infuzioni transparente dhe fleksibel e pershtatshme si per shishe edhe per qeset e infuzionit, e pajisur me valvol ajrimi + filter + age , luer luck + bashkuese e gomuar ne forme "Y" ose "flashball" , me PP flow rregullator , 20 pika / 1ml , e paketuar me qese te sterilizuar .	Copë
28	Doreza ekzaminimi (ndare sipas numrit)	Josterile , me latex natyral , me puder , me permasa XS, S, M, L.	Copë
29	Doreza kirurgjikale sterile (ndare sipas numrit)	Doreza kirurgjikale me puder, latex natyral, paketuar ne zarfe letre te sterilizuar me rreze Gama ose gaz Etilen sipas normativave EN; madhesia 6.5, 7, 7.5, 8, 8.5	pale
30	Lama bisturie	Nr: 15, 20, 21, 22, 23, 24	Copë
Materiale konsumi per respirim, aspirim, infuzion			
31	Filter baktericid	per respirim artificial, antibakterial, HMEF	Copë
32	Qarqe respiratori	per respirim artificial L= 1.5 m; ID 22 mm	Copë
33	Absorbues CO2 per Anestezi	Permbajtja: Hidroxid Calciumi dhe Natriumi. Granulariteti 3÷5 mm. pH: 12 - 14. Ndryshim ngjyre pas saturimit me CO2.	Kg
34	Tuba Guedel	Nr. 00, 0, 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8	Copë
35	Maske oksigjeni	me zgjatues L=1.5-2m	Copë
36	Sonde oksigjeni adult	nazale, adult, L=1.5-2 m	Copë

38	Kanjula nazale per CPAP	Per infant, ne permasa te ndryshme dhe tipologji sipas autoritetit kontraktor	Copë
39	Komplet aerosoli me tub zgajtues 1.5m	maske me rezervuar per medikamente	komplet
40	Furce orale	Per higjenizim oral ta pacientit para nderhyrjeve kirurgjikale dhe reanimacion. Pajisur me kanal te dyfishte per irrigim dhe aspirim. Material Silikoni.	Copë
41	Set drenimi Redon me vakum ne forme fizarmonike 500-800ml Komplet redoni G 12-22	Set=(ballon vakumi+form z fold tub+dren+troakar)	set
42	Dren pleural	Tip trocar me brima anash	Copë
43	Dren silikoni	Ch 16-28, L=50cm, me vrima a neseore i detektueshem nga rrezet X	Copë
44	Dren Kehr	silikon, Ch 10-14-16-18-20	Copë
45	Tub drenimi	silikon, rulon 20-30m, diam. 6-8mm dhe 8-10mm	meter
47	Dren torakal I drejte dhe anguluar	PVC, Ch16-Ch32	Copë
48	Dren abdominal double drain me katere te brendshem		Copë
49	Dren me troakar	Ch12-Ch20	Copë
50	Pleurovac me regullator tub zgjates me varse per krevat	3-chambers, tub zgjatues silikoni 1.8-2m, vellimi mbi 2100-2500ml, pajisur me rregullatore te integruar presioni dhe lageshtie dhe valvol sigurie	Copë
51	Set steril per funksionim vezike urinare	I perbere nga kateter silikoni me ballon, Ch 10-15 L= 40-70 cm, me introduktor te hapshem	set
52	Dilatator metalik vezikal me veshe metalik	C 16	Copë
53	Set steril per urografi retrograde	stente, klem, tub per kontrast bashkuese, (shiringe)	set
55	Set steril per drenim renal perkutan	set nefrotomie me age, introduktor, gide metalike, dilatatore, kateter L=20-30cm Ch 8-12	Copë
56	Stente ureterale	Set, stente double, J, 6Fr, 24-28mm, gide , pusher	Copë
57	Intraduktor jugular	per adulte	Copë
58	Maske per terapi CPAP	Madhesi e adoptueshme nga masa S deri ne L	Copë

59	Lageshtues per CPAP	Me tub konektor	Copë
60	Anse bipolare	Per resektoskop bipolar, 24Fr / 26 Fr, per urologji & gjinekologji.	Copë
61	Anse monopolare	Per resektoskop monopolar, 24Fr / 26 Fr, per urologji & gjinekologji.	Copë
62	Ansa koagulimi	Per resektoskop monopolar 24Fr, me rul sferik	
63	Vaj silikoni	Per litotripsi ekstrakorporale; shishe 500ml	Copë
64	Set tubimi laparoskopik, steril	Per irrigim te drejtuar, me dy age punkcioni, me membrane per monitorim te presionit te irrigimit.	set
65	Set tubimi endourologjik, steril	Per irrigim te drejtuar, me dy age punkcioni, me membrane per monitorim te presionit te irrigimit.	set
66	Set tubimi histeroskopik, steril	Per irrigim te drejtuar, me dy age punkcioni, me membrane per monitorim te presionit te irrigimit.	set
67	Filter insuflimi	Per insuflator pneumoperitonik	Copë
68	Age insuflimi pneumoperitonik	Tip Veress, L=120÷150 mm	Copë
69	Solucion glicerine	Ne shiringe 10 ml, solucion uje steril 90% dhe glicerine 10%, per urologji.	Copë
70	Kateter epidural	kateter 19G/20G+age epidurale+filter	Copë
71	Set epidural	kateter 19G/20G+age epidurale+gide +filter+ shiringe	set
72	Kateter venoz Seldinger 2-rruges	me dy rruge, tip Seldinger, L=20-30cm	Copë
73	Kateter arterial	20G-22G Seldinger	Copë
74	Kateter embolektomie	Me ballon, nr. 3, 4.	Copë
75	Aparat klizme adult		Copë
80	Zhgute		Copë
81	Tuba endotrakeale pediatrike	ID 2 - 5mm, nazal/oral	Copë
82	Tuba endotrakeale adult	ID 5.5mm-8.5mm, nazal/oral, me ballon	Copë

84	Kateter aspirimi adult	Ch 12, 14, 16, 18.	Copë
86	Kateter aspirimi adult me kontroll vakumi	Ch 12, 14, 16, 18.	Copë
87	Set aspirimi	Set =(kanjule 26x6mm+tub 1.8-2.5m)	set
88	Tub endobronkial	PVC e silikonizuar, me dy balona presioni, maje atraumatike, vijezi i detektueshem nga x -ray pergjate tubit, i graduar, me dy konektore 15 mm, me grep per carina; 35FR , 37Fr, 39Fr, 41Fr	Copë
89	Tub endotrakeal 7.5	ID 7.5 mm, nazo-oral, me ballon	Copë
90	Tub endotrakeal 8.0	ID 8.0mm, nazo-oral, me ballon	Copë
92	Maske Laringeale Silikon	Maske Silikon me nje perdorim. Madhesia Nr.1÷5	Copë
96	Spekulum vaginal	Steril, nje perdorimesh.	Copë
97	Set punkcioni pleural	Set i perbere nga age veres, kateter drenimi 9-12Fr gjatesi 40÷50cm, qese drenimi min.2000ml, me valvul hyrese dhe shkarkimi.	Copë
98	Petzer	Nr 18-20-22-24	Copë
99	Mbulese Kamere	sterile, per kamera endoskopike	Copë
100	Qese ekstraktimi e vogel	Vellimi 180-220ml, me dy seksione, seksioni punues me diameter 7-8cm, me lak mbylles, per laparoskopji me trokare 10-11mm	Copë
101	Qese ekstraktimi e madhe	Vellimi 250-300ml, me dy seksione, seksioni punues diameter 9-11cm lak mbylles, per laparoskopji me trokare 10-11mm	Copë
	Materiale konsumi per monitorim diagnostike		

102	Leter printeri ECHO		Copë
107	6-12 kanale		Copë
108	Leter printer monitori		Copë
110	Xhel per ECHO	Bidone 5 kg , Xhel - Transonic / Transparent , densiteti - 1/02 gr /ml + nje pistone dhe dy shishe 250 ml boshe , per cdo kater bidona	Copë
111	Xhel per EKG	Bidon 5 kg , Elektro-Xhel / ECG , densiteti - - 1/02 gr /ml + nje pistone dhe dy shishe 250 ml boshe , per cdo kater bidona	Copë
112	Elektroda monitorimi EKG	Elektroda monitorimi njeperdorimeshe	Copë
115	Aparat tensioni	Me manometer	Copë
116	Steto-fonendoskop	Koke e sheshte	Copë
118	Termometer	termometer pacienti	Copë
119	Spatula (druri)	Sterile, e pakeluar individualisht	Copë
122	Gojez spirometrike		Copë
123	Filter spirometrik antibakterial		Copë
124	Set Filter spirometrik antibakterial	Set i perbere nga: filter antibakterial, gojez spirometrike, dhe klipi nasal	Copë
129	Paste EEG / EMG	Adhesive ose Abrasive 250g	Copë
138	Sensor oksimetrine	Per monitore pacienti. Shumepdorimesh	Copë
139	Mansheta monitorimi TA	Per monitore pacienti. Shumepdorimesh	Copë

Specifikimete teknike te pergjithshme :

Materialet e mjekimit duhet të permbushin standartet CE ose CE sipas direktivës MDD/MDR 93/42 EEC. Ato duhet të jenë të markuara CE në momentin e lëvrimit të mallit.

Afati i skadencës: jo më të vogël se 12 muaj nga data e lëvrimit të mallit në destinacion.

Skadencia duhet të jetë e shënuar në ambalazh.

Ambalazhimi të jetë i përshtatshëm sipas llojit të mallit të shoqëruar me etiketat dhe markimin përkatës.

Ofertuesi duhet të përmbushë specifikimet teknike të materialeve mjekësore detyrimisht sipas përcaktimit të bërë në përshkrimin e mallrave në DST të kësaj procedurë prokurimi.

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që

garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Argumentim: Në bazë të nenit të 36, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 15, pika 3/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Dokumentat e tenderit janë hartuar bazuar në ligjin nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Referuar pikës 5 të nenit 82 të Ligjit 162 date 23.12.2020 “Për prokurimin publik” operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike si dhe dokumentet mbështetëse në origjinal ose një kopje të noterizuar të tyre për vetëdeklarimet e dhëna, jo me vone se 5 dite nga publikimi i njoftimit të fituesit përfundimtar.

NJËSIA E PROKURIMIT